



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 651 Prot.

Tiranë, më 06/6 /2016

REKOMANDIM

*(Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale nga organet e vetëqeverisjes vendore)*

Nr. 11 datë 06/6 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, në kuadër të mbikëqyrjes së aktivitetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, në përmbushje të respektimit të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me qëllim disiplinimin dhe sensibilizimin e këtij sektori;

KONSTATOVA:

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të impaktit që ka mbi qytetarët në lidhje me ushtrimin e detyrave funksionale, me qëllim respektimin e detyrimeve ligjore përkatëse nga ana e kontrolluesve që veprojnë në këtë sektor.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm, procesin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetin. Në këtë kuadër, janë evidentuar disa nga problematikat e hasura më shpesh në këtë fushë, referuar praktikës së deritanishme në zbatim të ushtrimit të funksionit monitorues dhe mbikëqyrës së Zyrës së Komisionerit në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, mangësi të konstatuara gjatë hetimeve administrative të ushtruara dhe ankesave të subjekteve të të dhënave personale të trajtuara nga Zyra e Komisionerit.

Sa më sipër, në vijim do të gjeni disa detyrime ligjore për tu përmbushur në funksion të respektimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Publikimi i rubrikës "politikat e privatësisë" në faqen zyrtare online në internet.** Në këtë rubrikë duhet të publikohen të drejtat ligjore të subjektit të të dhënave, qëllimi dhe mënyra e përpunimit të të dhënave personale, afati i mbajtjes dhe masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale. "Politikat e privatësisë" synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që individët gëzojnë në këtë fushë. Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mungesa e rubrikës së privatësisë në faqen tuaj online, përbën shkelje të nenit

18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Gjithashtu, kontrolluesi rezervon të drejtën dhe detyrimin që të ndryshojë apo modifikojë këtë politikë privatësie, në zbatim të çdo ndryshimi të mundshëm të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

*Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit (nenet 21, 22 të ligjit). Detyrimi për njoftim është një nga detyrimet bazë që ka çdo kontrollues dhe duhet të plotësohet përpara se kontrolluesi të fillojë përpunimin e të dhënave personale. Detyrimi për njoftim dhe përditësimi i tij nuk mund të konsiderohet i përfunduar dhe i pandryshueshëm në kohë, por ekziston në çdo rast kur ndryshon një nga elementët e “Formularit të Njoftimit”. Detyrimi për njoftim dhe përditësimi i “Formularit të Njoftimit” është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji. Mospërbushja e detyrimit për njoftim përbën shkelje të neneve 21, 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.*

*Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të hartojnë rregullore të brendshme mbi sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen masat konkrete organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrimi i paligjshëm, humbjet aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen në persona të paautorizuar. Hartimi i një rregulloreje të tillë është i rëndësishëm për kontrolluesit pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Rregullorja duhet të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale dhe për çdo kategori subjektësh të të dhënave. Mungesa e një rregulloreje përbën shkelje të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.*

*Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të tregojnë kujdes në lidhje me publikimin e informacionin mbi subjektet e të dhënave personale në internet ose forma të tjera publikimi. Edhe në rast se publikimi i informacionit me të dhëna personale, është i detyrueshëm në bazë të një parashikimi ligjor ose nënligjor, në çdo rast duhet patur në vëmendje respektimi i detyrimeve ligjore në kuadër të sasisë së informacionit të publikuar në përmbushje të qëllimit dhe respektimi i neneve 5, 6 të ligjit.*

Në këtë kuptim, psh., informacioni mbi subjektet e të dhënave të cilët janë përfitues të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, nxënës që marrin bursë, personave në nevojë ose me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, janë të dhëna personale dhe duhet treguar kujdes në publikimin e informacionit në lidhje me ta. Për më tepër, të dhënat personale të personave me aftësi të kufizuara, (ose kategori të tjera sipas nenit 3, pika 4 të ligjit) janë të dhëna të kategorisë sensitive, dhe sipas përcaktimeve të nenit 7 të ligjit, gëzojnë një mbrojtje të veçantë.

Gjithashtu, në lidhje me mbledhjen dhe publikimin e të dhënave personale në faqen e internetit, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ju bëjmë me dije se është i detyrueshëm për zbatim. Udhëzimi Nr. 39, datë 05.08.2013 “Për përpunimin e të dhënave personale në regjistrat publike” i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i botuar në Fletore Zyrtare, i cili mund të gjendet lehtësisht edhe në portalin zyrtar [www.idp.al](http://www.idp.al).

Në çdo rast, gjatë publikimit çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, ka detyrimin për informim të publikut, subjekte të të dhënave personale. Ky detyrim rrjedh nga përcaktimet e nenit 18. të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, “Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.

Në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale”.

Standartet që përcakton ligji, në nenin 5, 6 të tij apo nenet e tjera mbi përpunimin e të dhënave personale si saktësia e mbledhjes së informacionit, informimi, pëlqimi, mjaftueshmëria etj, i referohen jo vetëm trajtimit nga kontrolluesit të informacionit personal që nuk ka për qëllim të bëhet publik por, gjithashtu përcaktojnë standarte që së bashku lehtësojnë mbledhjen dhe trajtimin e duhur të informacionit që përmbajnë edhe baza të dhënash që kanë si qëllim bërjen të njohur ndaj publikut të gjerë të këtij informacioni (psh., personave që përfitojnë ndihmë ekonomike, nxënës që marrin bursë dhe shërbime të tjera që u kryen qytetarëve si më lartë referuar).

Sa më sipër,

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;

#### REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, në faqen tuaj online të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë”, ku të përfshihet informimi i subjekteve të të dhënave si dhe kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Për plotësimin e këtij detyrimi mund t’i referoheni Opinioneve të Komisionerit “Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në faqen e internetit të kontrolluesve publik dhe privat”, i publikuar në faqen zyrtare të KDIMDP-së në adresën [www.idp.al](http://www.idp.al), rubrika ‘legjislacion/opinione’. Gjithashtu, edhe pas publikimit të tregohet kujdes në ndryshimin apo modifikimin e kësaj rubrike në zbatim të çdo ndryshimi të mundshëm të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
2. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të plotësohet detyrimi për njoftim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat nuk e kanë zbatuar këtë detyrim për herë të parë si dhe të tregohet kujdes në vijimësi, në përditësimin e njoftimit për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

3. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme mbi sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen masat konkrete organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, afatet për mbajtjen e të dhënave, etj. Për plotësimin e këtij detyrimi mund t'i referoheni rregullores tip për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", publikuar në faqen zyrtare të KDIMDP-së në adresën [www.idp.al](http://www.idp.al), rubrika 'për kontrolluesin'.
4. Kontrolluesi, gjatë administrimit dhe publikimit të të dhënave personale që përmbahen në vendimet e këshillave bashkiak ose listat e personave që përfitojnë ndihmë ekonomike, nxënës që marrin bursë pagesën për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbime të tjera që iu ofrohen qytetarëve, të respektojë kushtet e kriteret e përcaktuara në nenet 5, 6 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr. 39, datë 05.08.2013 "Për përpunimin e të dhënave personale në regjistrat publikë" të Komisionerit.
5. Të njoftohet me shkrim pranë Zyrës së Komisionerit mbi masat e marra në zbatim të Rekomandimit të mbështetura nga aktet përkatëse. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë edhe objekt hetimi administrativ në vazhdimësi.
6. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 06/6 2016.

Besnik DERVISHI  
  
KOMISIONERI  
